



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2657/2 prot.

Datë 19.09.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-06445-05-24-2024, me objekt: “LOTI I: “Blerje pajisje didaktike për fizikë, arsimit bazë dhe i mesëm” me fond limit 116,935,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga BOE “Marketing & Distribution & Euromed” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

Mbetjen të skualifikuar të operatorit ekonomik “Isometric” SHPK në

Ankimues:

Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I dhe adresë: Rruga Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
Adresa: “Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Farma Net Albania” me NIPT K92201080V dhe adresë: Njesia Bashkiake nr 8, Rruga Siri Kodra, ndertese 2-kateshe , me zone kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/66 , Tiranë.

BOE “Marketing & Distribution & Euromed” SHPK me NUIS J72124001N +K71718012P dhe adresë autostrada Tirane - Durres, Km.10, Tiranë.

Operatori ekonomik “Isometric” SHPK me NIPT L92207009A dhe adresë Rruga Dibres Kompleksi Arlis Farmacia 10 shk.2 App. 2, Tiranë.

Në datën 18.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4571 si dhe nr. Protokollit 2657/2024 datë 18.09.2024 i operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-06445-05-24-2024, me objekt: “LOTI I: “Blerje pajisje didaktike për fizikë, arsimit bazë dhe i mesëm” me fond limit 116,935,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 12-08-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Farma Net Albania” SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, me shtim të arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik BOE “Marketing & Distribution & Euromed” SHPK, si dhe me lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Isometric” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime”*.

- Lidhur me peratorin ekonomik “Farma Net Albania” SHPK, ankimuesi pretendon se nuk përmbush kërkesat/kriteret si me poshte:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së përlllogaritur të lotit apo grupeve të lotëve në rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët teknikë për mallrat e kërkuar sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit. Në rastin e përsëritjes së artikujve në lista mjafton 1 (një) katalog teknik për artikull. Gjuha e katalogut mund të jete shqip ose anglisht.

- Lidhur me operatorin ekonomik BOE “Marketing & Distribution & Euromed” SHPK, ankimuesi pretendon se nuk plotëson kriteret e kualifikimit:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39% të vlerës së përlllogaritur të lotit apo grupeve të lotëve në rast se ofertuesi i suksesshem merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime që artikujt e prezantuar nga kompania Marketing&Distribution dhe Euromed shpk të verifikohet kurrikula në të cilën bazohen dhe të

verifikohen manualet e perdorimit sipas kerkeses ne specifikime (per te gjitha kitet ku kerkohen manualet sipas listes se mesiperme) per te vertetuar qe keto artikuj nuk jane thjesht te pershkruara sipas te specifikimeve te DST-se, por pershkruajne eksperimentet dhe kryejne funksionin sipas qellimit /kerkeses se Autoritetit Kontraktor.

- Lidhur me operatorin ekonomik “Isometric” SHPK ankimuesi kërkon lënien të skualifikuar të tij.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 19.09.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri